# DORËZIMI VULLNETAR I ARMËVE
# TANI DHE NGA NXËNËSIT

**Nga Adriana Hyso**

## Merr pjesë ministri Gjoni[1]

Ministri i Rendit Ilir Gjoni për të satën herë brenda në kohe të shkurtër, zbret në Fier në një nismë tjetër të Drejtorit të Policisë të Qarkut Fier, zotit Xhavit Shala.

Sipas tij, suksesi i kësaj drejtorie në shumë drejtime është shkaku që këtu bëhet lançimi i disa nismave në shkallë vendi.

Ka shërbyer pikërisht dorëzimi vullnetar i armëve nga nxënës të një prej shkollave të Levanit (një nga zonat e nxehta të Fierit porsa i përket krimeve apo qarkullimit të armëve) si motiv i vizitës së Ministrit Gjoni këtu. Gjoni ka vlerësuar edhe njëherë punën e kësaj drejtorie në këtë shembull origjinal të dorëzimit të armeve sipas tij.

"Gjatë një viti që unë kam qenë ministër, Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, ka qenë nismëtare e shumë veprimtarive në shkallë vendi, duke filluar që nga Konferenca Rajonale e Luftës kundër bimëve narkotike e cila më tej u shtri masivisht në të gjithë gjeografinë e vendit, apo, duke shkuar më tej, me Konferencën Rajonale të çarmatimit dhe atë të kundër trafikut të qenieve njerëzore.

Sipas Gjonit, Drejtori i Policisë së Fierit Xhavit Shala gjatë një viti i ka dhënë një tjetër imazh luftës kundër krimit dhe llojeve të ndryshme të trafiqeve në këtë rajon. Kolonel Shala, kohët e fundit, ka gjetur mjaft forma origjinale për grumbullimin e armëve, duke u nisur që nga nisma "Një polic një armë", "Një nëpunës një armë", për të përfunduar tek ndihma e komunitetit të nxënësve. Nisma e fundit është realizuar në bashkëpunim me strukturat arsimore në Fier.

Gjatë takimit ministri Gjoni i ka mëshuar edhe luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë. Ai nuk ka mohuar faktin e ekzistencës së elementëve të tillë aktualisht. Pyetjes se nëse Gjoni është në dijeni të emrave konkretë në radhët e policisë së Fierit, ai sqaron se ligji i shtetit i ka ndarë qartë funksionet e drejtimit të kësaj policie.

"Unë, si ministër, nuk mund të them emra konkretë, por informacion sigurisht që kam" përgjigjet Gjoni, duke ia lënë kështu të drejtën e publikimit të tyre, drejtorit Shala.

---

[1] Shkrimi është botuar në gazetën "Zëri Popullit" datë 10.11.2001

"Është fakt,-ka vazhduar ai,- që në Policinë e Shtetit, ndryshe nga strukturat e tjera shtetërore, lufta ndaj korrupsionit është më e fortë për vetë natyrën e punës që ka policia. Vetëm brenda një viti janë larguar nga radhët e policisë mbi 50 policë apo punonjës policie për arsye të ndryshme, duke filluar që nga korrupsioni, abuzimi me ligjin, shkeljen e të drejtave të njeriut, shkeljen e kodit të etikës të cilat bien me ligjin i cili rregullon veprimtarinë e policisë së shtetit", ka përfunduar Gjoni.

ÇARMATIMI

## Dorëzimi vullnetar i armëve tani edhe nga nxënësit, merr pjesë ministri Gjoni

FIER- Ministri i Rendit Ilir Gjoni për të disatën herë, brenda një kohe të shkurtër, zbret në Fier në një nismë tjetër të drejtorit të Policisë së Qarkut Fier, zotit Xhavit Shala.

Sipas tij, suksesi i kësaj drejtorie në shumë drejtime, është shkaku që, këtu të bëhet lancimi i disa nismave në shkallë vendi.

Ka shërbyer pikërisht, dorëzimi vullnetar i armëve nga nxënës të një prej shkollave të Levanit (një nga zonat e nxehta të Fierit përsa i përket krimeve apo qarkullimit të armëve) si motiv i vizites së Ministrit Gjoni këtu.



NË FOTO: Ministri i Rendit Ilir Gjoni dje në Fier

Gjoni ka vlerësuar edhe njëherë punën e kësaj drejtorie në këtë shembull origjinal të dorëzimit të armëve - sipas tij, "Gjatë një viti që unë kam qenë minister, drejtoria e policisë së qarkut Fier, ka qenë nismëtare e shumë veprimtarive në shkallë vendi, duke filluar që nga konferenca rajonale e luftës kundër bimëve narkotike, e cila më tej u shtri masivisht në të gjithë gjeografinë e vendit, apo duke shkuar më tej me konferencën rajonale të çarmatimit dhe pasuar me konferencën kundër trafikut të qënieve njerëzore.

Sipas Gjonit, drejtori i policisë së Fierit Xhavit Shala, gjatë një viti i ka dhënë një imazh tjetër luftës kundër krimit dhe llojeve të ndryshme të trafiqeve në këtë rajon. Kolonel Shala, kohët e fundit ka gjetur mjaft forma origjinale për grumbullimin e armëve, duke nisur që nga nisma "Një polic një armë", "Një nëpunës një armë", për të përfunduar tek ndihma e komunitetit të nxënësve. Nisma e fundit është realizuar në bashkëpunim me strukturat arsimore në Fier.

Gjatë takimit ministri Gjoni i ka mëshuar edhe luftës kundër korrupsionit në radhët e policisë. Ai nuk e ka mohuar faktin e ekzistencës së elementëve të tillë aktualisht. Pyetjes se, - nëse Gjoni është në dijeni të emrave konkret në radhët e policisë së Fierit, - ai sqaron se, - ligji i shtetit i ka ndarë qartë funksionet e drejtimit të kësaj policie.

"Unë si ministër, nuk mund të them emra konkret, - por informacion, sigurisht që kam" - duke ia lënë kështu të drejtën e publikumit të tyre, drejtorit Xhavit Shala. Është fakt, - ka vazhduar ai, që në policinë e shtetit, ndryshe nga strukturat e tjera shtetërore, lufta ndaj korrupsionit është edhe më e fortë për vetë natyrën e punës që ka policia.

Vetëm brenda një viti, janë larguar nga radhët e policisë, mbi 50 policë apo punonjës policie për arsye të ndryshme, duke filluar nga korrupsioni, abuzimi në ligj, shkeljen e të drejtave të njeriut, shkeljen e kodit etik, të cilat bien ndesh me ligjin, i cili rregullon veprimtarinë e policisë së shtetit", - ka përfunduar Gjoni.

Adriana Hyso

QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NENE TEREZA"

NJOFTIM PUNE

Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza" kërkon të punësojë një

**Fizikant**

që të plotësojë këto kritere:

1. Të ketë mbaruar Fizikën pesë vjeçare.
2. Të jetë në moshën 35 vjeç.
3. Të ketë mbrojtur gjuhën e huaj (preferohet anglishtja).
4. Të ketë njohuri mbi kompjuterin (me dëshmi).

KANDIDATET TE PARAQESIN DOKUMENTACIONIN PRANE DEGES SE PERSONELIT TE Q.S.U.T., BRENDA DT.20.11.2001

ZERI POPULLIT 10.11.2001